



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

KRYETARE

Nr. 485/1 Prot.

Shkodër, më 04.01.2023

Vendim

Nr. 22, Datë 28 / 12 / 2023

**“Mbi miratimin e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024”**

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e Datës 28/12/2023, me propozim të Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër **“Mbi miratimin e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024”**, bazuar në: pikën 5 të nenit 72, neni 77,78 i Ligjit Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 **“Për vetëqeverisjen vendore”**, germën “c” të nenit 9 të Ligjit nr.35/2023 **“Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe pagës minimale në shkallë vendi”**, VKM-në Nr.328 Datë 31.05.2023 **“Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e e njësisve të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësisve të vetëqeverisjes vendore”**, Ligjin nr.97, 07.12.2023 **“Për buxhetin e vitit 2024”**; Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **15 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim.**

### VENDOSI:

1. Të miratojë shpërblimin mujor të Anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për Vitin 2024, i cili do të jetë në masën 10% të pagës së Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër .
2. Burimi financiar do jenë transferta e pakushtëzuar, sipas detajimit të Buxhetit të Vitit 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

### RELACION

#### “Mbi miratimin e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024”

Institucioni i Këshillit të Qarkut Shkodër paraqet për shqyrtim, diskutim dhe miratim Përqindjen e *Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024*.

Duke u bazuar në përmbajtjen e Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përkatësisht në pikën 5 të nenit 72, ku thuhet se “anëtarët e këshillit të qarkut kryejnë funksione pa shpërblim, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur anëtarë të kryesisë së këshillit të qarkut”, neni 78, germën “c” të nenit 9 të Ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe pagës minimale në shkallë vendi”, VKM-në Nr.328 Datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, sipas të cilit “shpërblimi mujor deri në masën 10% të pagës mujore të kryetarit të këshillit të qarkut”, paraqesim për miratim përqindjen e *Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024*.

Për vitin 2024, Institucioni i Këshillit të Qarkut Shkodër propozon për të miratuar masën e shpërblimit mujor të *anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodëri cili të jetë 10% e pagës së Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër dhe çdo ndryshim page i kryetares do të reflektohet edhe në ndryshimin e pages se anetareve të kryesisë*.

Presim miratimin tuaj për këtë Projekt-Vendim.

**Nëpunësi Zbatues**

**Gjyljana MIRUKU**



**Marina DUHANI**